MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
NR. 446 PROT.
DATE 3 19.3.2002

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E RENDIT PUBLIK**
**MINISTRI**

Dr. Jur. M. Jostto
D.P.A.C.
19.03.

Nr. 514/1 Prot.

Tirane, me 18.3.2002

L e n d a : *Mendim per nje projektligj.*

**MINISTRISE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT**

**TIRANE**

Per projektligjin "Mbi aderimin e Republikes se Shqiperise ne konventen *"Mbi etiketimin e eksploziveve plastike per qellim zbulimi*", te derguar per mendim nuk kemi verejtje.

Njekohesisht, kujtojme se ne vendin tone nuk prodhohen lende eksplozive plastike, si dhe aktualisht mundesite reale te zbulimit te kesaj lende ne vendin tone mungojne.

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRI MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

**M I N I S T R I**

**STEFAN ÇIPA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
NR. 446/ PROT.
DATE 12.19.3.2002

Nr 1714 Prot.

Tirane, me 18.03.2002

**Lenda**: Mendim per nje projekt-ligj

**MINISTRISE SE TRANSPORTEVE DHE TELEKOMUNIKACIONIT**

**TIRANE**

Pasi studiuam me vemendje projekt-ligjin "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Konventen "Mbi etiketimin e eksploziveve plastike per qellim zbulimi", nuk kemi verejtje dhe shprehemi dakort per miratimin e tij.

Ju faleminderit per bashkepunimin.

**MINISTRI**

**LUAN RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
Drejtoria Juridike, Konsullore dhe e Traktateve

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
NR 446/1 PROT.
DATE 6.3.2002

**Nr. 1355 Prot.** **Tirane, me 5.03.2002**

M. punë Jashtë
D.P.A.C.
Juristëve
06.03.02

**LENDA:** *Jepet mendim per nje projekt-ligj.*

**MINISTRISE SE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT**
**DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE AVIACIONIT CIVIL**
**TIRANE**

Studiuam projekt-ligjin "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Konventen mbi etiketimin e eksploziveve plastike per qellim zbulimi" dhe ne parim jemi dakort me te.

**MINISTRI**

**Arta DADE**

**RELACION SHPJEGUES**

**PER**

**MIRATIMIN NE PARIM TE PROJEKT-VENDIMIT PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN "MBI ETIKETIMIN E EKSPLOZIVEVE PLASTIKE PER QELLIM ZBULIMI"**

Domosdoshmeria e miratimit te Projek-Vendimit mbi aderimin nga Republika e Shqiperise ne Konventen "Mbi Etiketimin e Eksploziveve Plastike per Qellim Zbulimi" rrjedh nga intesifikimi dhe perpjekjet tona per zbatimin e rekomandimeve, praktikave, dhe procedurave ne lidhje me sigurine e aviacionit civil.

Miratimi i ketij Projekt-Vendimi do te nxise kerkimin dhe zhvillimin e pajisjeve te sigurise, ne vecanti per zbulimin e eksploziveve, dhe per te vazhduar inkujarimin ne kerkimin dhe zhvillimin ,nepermjet permiresimit te mjeteve ekonomike, te te gjithe agjenteve zbulues, sic specifikohet ne kete Konvente.

Miratimi i ketij Projekt-Vendimi do te rrise uniformitetin ne perputhje me Aneksin 17 te ICAO-s, cka do te coje ne dhenien e ndihmes konkrete nga mekanizma te ICAO-s, me asistence teknike dhe materiale ne lidhje me sigurine e Aviacionit Civil.

Duke qene se aktet terroriste synojne ne shkaterrimin e Avionit duke perdorur lloje te ndryshme eksplozivesh, nder te cilet edhe eksplozivet plastike per nje qellim te tille, jane te domosdoshme perpjektjet e ICAO-s per te intensifikuar punen e saj ne projektimin e nje Rregjimi Nderkombetar per Etiketimin e Eksploziveve Plastike per Qellim Zbulimi.

Kjo Konvente detyron cdo Shtet qe prodhon eksplozive plastike qe ne permbajtje te tyre te fuse elemente te tille te cilet e bejne ate te zbulueshem nga organet kompetente , pra te paperdorshem nga elemente keqberes.

Duke e konsideruar sigurine si nje element shume te rendesishem per fushen e Aviacionit civil, si dhe duke marre parasysh rekomandimet e bera nga ICAO, miratimi i ketij Projekt-Vendimi do te ishte mjaft i rendesishem per sigurine e Aviacionit Civil Shqiptar cka do te conte drejt kompletimit te plote te kuadrit ligjor ne kete fushe.

**Maqo LAKRORI**

**MINISTER**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT

# VENDIM

**Nr....date......**

**PER**

## MIRATIMIN NE PARIM TE ADERIMIT TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN "MBI ETIKETIMIN E EKSPLOZIVEVE PLASTIKE PER QELLIM ZBULIMI"

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 5 te Ligjit nr. 8371, date 9.7.1998, "Per lidhjen e Traktateve dhe Marreveshjeve nderkombetare", me propozimin e Ministrit te Transportit dhe Telekomunikacionit, Keshilli I Ministrave :

V E N D O S I:

Miratimin ne parim te aderimit te Republikes se Shqiperise ne Konventen "Mbi Etiketimin e Eksploziveve Plastike per Qellim Zbulimi" .

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**K R Y E M I N I S T R**

**Pandeli MAJKO**

**Minister i Transportit**
**dhe Telekomunikacionit**

**Maqo LAKRORI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

Ministria e Transportit

DREJTORIA E PERGJITHSHME E AVIACIONIT CIVIL

Nr. 97 Prot. Tiranë më, 23/03/2002

**Lënda:** MBI RATIFIKIMIN E KONVENTES"MBI ETIKETIMIN E EKSPLOZIVEVE PLASTIKE PER QELLIME ZBULIMI ".

Z. MAQO LAKRORI

MINISTER I TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

TIRANE

Z. Minister,

Duke Ju uruar per riemerimin Tuaj ne detyren e Ministrit te Transportit dhe Telekomunikacionit dhe duke Ju siguruar mbeshtetjen dhe perkushtimin maksimal timin, si dhe te Drejtorise se Pergjitheshme te Aviacionit Civil, ne realizmin e detyrave te programit te qeverise, si dhe te detyrave te tjera funksionale te ketij institucioni, Ju dergoj bashkengjitur, Konventen "Mbi Etiketimin e Eksploziveve Plastike per qellime zbulimi ", hartuar ne Montreal ne 1 Mars 1991.Ratifikimi I kesaj Konvente nga shtetet anetare te ICAO-s ,u shtrua si domosdoshmeri ne Konferencen Ministrore per sigurine e Aviacionit Civil , zhvilluar ne Montreal 19-20 Shkurt 2002.

Kjo konvente eshte e domsdoshme te ratifikohet, ne vazhden e perpjekjeve per realizmin e nje regjimi nderkombetar sigurie ne Aviacion, sidomos mbas ngjarjeve te 11shtatorit 2001 ne USA.

Duke Ju pergjigjur menjehere ketij rekomandimi te ICAO-s, Ju lutemi mbeshtetjen tuaj, per te marre sa me shpejte miratimin e Ministrive perkatese per kete qellim.

Me Respekt,

Merita XHAFAJ
Drejtor I Pergjithshem

Adresa. Sheshi "Skenderbej"; Tel : ++355 (42) 23969; Fax : ++355 (42) 23969

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
***MINISTRIA E TRANSPORTIT***
***DHE TELEKOMUNIKACIONIT***
**Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil**

Nr….Prot.                                                                 Tirane,me__.__.2002

**Lenda:** Marrje mendimi per miratimin ne parim te nje projekt-vendimi.

**Z. Spiro Peci**
**Minister i Drejtesise**

**Znj. Arta Dade**
**Minister i Puneve te Jashtme**

**Z. Luan Rama**
**Minister i Mbrojtjes**

**Z. Stefan Cipa**
**Minister i Rendit Publik**

**Tirane**

Bashkelidhur po Ju dergojme per marrje mendimi, per miratimin ne parim te nje projekt-vendimi, mbi aderimin e Republikes se Shqiperise ne Konventen "Mbi Etiketimin e Eksploziveve Plastike per Qellim Zbulimi" se bashku me relacionin shpjegues dhe tekstin e perkthyer te Konventes ne fjale.
Lutemi miratimin tuaj.

Maqo LAKRORI

MINISTER